



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr. 124, datë 15.05.2020

PËR MIRATIMIN E KOMENTEVE DHE KUNDËRSHTIMEVE NDAJ RAPORTIT TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS ME REZULTATET E VLERËSIMIT PARAPRAK TË KANDIDATËVE QË KANË APLIKUAR PËR PRANIMIN NË FORMIMIN FILLESTAR NË VITIN AKADEMIK 2020-2021, PROFILI PROKUROR

Këshilli i Lartë i Prokurorisë bazuar në nenin 149/a, pika 1, germa “e”, të Kushtetutës, në nenin 30, pika 4, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar si dhe në nenin 189 të Ligjit Nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Veprimtarisë Etike dhe Profesionale,

V E N D O S I:

1. Miratimin e komenteve dhe kundërshtimeve ndaj raportit të Shkollës së Magjistraturës me rezultatet e vlerësimit paraprak të kandidatëve që kanë aplikuar për pranimin në Formimin Fillestar në vitin akademik 2020-2021, profili prokuror, sipas relacionit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

KRYETAR

GENT IBRAHIMI

